




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.1, dhe 17 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, dhe neneve 9 shkronja a) dhe 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 31. 07. 2017, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë :

VENDIM
PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK
LOKAL TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR PERIUDHËN 2018-2023

Neni 1

TË HARTOHET, Projekti i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Lipjanit, për periudhën 2018-2023.

Neni 2

Qëllimi i hartimit të projekt-dokumentit të Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal të Komunës së Lipjanit është definimi i prioritetëve të ardhëshme strategjike, ndërtimit të kapaciteteve të institucioneve lokale dhe resurset njerëzore për planifikim dhe drejtim të zhvillimit ekonomik lokal.

Fillimi i procedurave për hartimin e këtij dokumenti bëhet duke u bazuar në faktin se Strategjia paraprake e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2012-2017, e aprovuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës 15Nr.06-22/1 i datës 27.12.2011, është hartuar për periudhë pesëvjeqare 2012-2017, çka nënkupton se janë plotësuar kushtet ligjore edhe në pikëpamje të kohës për hartimin e Projektit të Strategjisë së re të Zhvillimit Ekonomik lokal të Komunës .

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal përfaqëson një nga shtyllat kryesore të Strategjisë Zhvillimore Komunale, kështu që në përputhje me këtë duhet të përmbajë: qëllimet strategjike, objektivat, programet dhe ndërhyrjet tjera konkrete që shërbejnë për arritjen e vizionit të Komunës.

Neni 3

Bartës i procesit të hartimit të dokumentit të Strategjisë deri në finalizim do të jetë Komisioni Komunal i i cili do të formohet me Vendim nga Kryetari i Komunës i cili do të ketë prej 7 deri një 11 anëtar në përbërjen e të cilit do të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm.

Komisioni është i obligur që në afatin prej 6 muajsh të harton Projektin e Strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal .

Punët administrative teknike për Komisionin do t'i kryej Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim në bashkëpunim me Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 4

Projekti i Strategjisë e Zhvillimit Ekonomik duhet të vëhet në shqyrtim publik dhe Webfaqen e Komunës për komente. Paraqitja e dokumentit SZHEL në shqyrtimin publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në mjetet e informimit.

Neni 5

Mjetet për hartimin e dokumentit sigurohen nga buxheti i Komunës, që rezulton me procedurat e përgjithshme të cilat rezultojnë me mbështetje financiare për punën e Komisionit, përgatitjen teknike dhe përfundimisht botimi i dokumentit dhe publikimi.

Neni 6

Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik hartohet për periudhën 5 vjeqare.

Neni 7

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal dhe publikimit në Webfaqen e Komunës

15Nr. 011-41551
Lipjan më 01. 08. 2017

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

**Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani - Hajnuni**

